



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN  
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT



This project is funded  
by the European Union



# PERCEPTIMI DHE NJOHURITË E TË RINJVE DHE MESUESVE MBI TE DREJTAT E FEMIJËVE DHE TRAFIKIMIN NJERËZOR

*Publikuar në Prill 2017*

## Hyrje

Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e fëmijës” shënoi një pikë kthimi, duke bërë të njohur në mbarë botën që fëmijët nuk janë vetëm subjekte të mbrojtjes, por, gjithashtu, mbajtës të të drejtave civile dhe politike. KDF është traktati i parë universal për të drejtat e njeriut që kombinon të drejtat ekonomike, sociale, kulturore, si dhe civile dhe politike në një dokument të vetëm. KDF ndjek një qasje gjithëpërfshirëse për adresimin e situatës për fëmijë; ai shkon përtej deklaratave më të hershme për fëmijë, të cilat ishin fokusuar në nevojat e mbrojtjes gjatë zhvillimi të fëmijës, si dhe përfshin kushtet e garantimit të respektit për identitetin e fëmijës, vetëvendosjes dhe pjesëmarrjes.

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi ka qenë në hije të politikave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për një kohë të gjatë. Me miratimin e Ligjit “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, u bë një hap i madh përpara, pasi për herë të parë u shpreh qartë në legjislacionin kombëtar e drejta e fëmijëve për të qenë të mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, përfshirë edhe ndaj ndëshkimit trupor. Gjithashtu me anë të këtij ligji u identifikuan struktura të posaçme që do të kishin si përgjegjësi kryesore mbrojtjen e fëmijëve.

Mbrojtja e fëmijës realizohet nga një mori normash ligjore të sanksionuara në legjislacionin ekzistues. Këtu përfshihet Kushtetuta, ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe kode të ndryshme (penal, civil dhe familjar).

Fëmijët në Shqipëri përballen me një sërë rreziqesh dhe shkeljesh që lidhen me mbrojtjen, të cilat ndikojnë negativisht në jetën e tyre, dhe të familjeve të tyre. Varfëria është një fenomen i përhapur dhe në rritje. Fëmijët gjithashtu i përkasin atij grupi të popullsisë që është objekt trafikimi i qenieve njerëzore. Fëmijët në lëvizje janë të ekspozuar ndaj të gjitha llojeve të risqeve, krahasuar me bashkëmoshatarët miqtë. e tyre. Shfrytëzimi ekonomik është një plagë e dukshme që ndikon tek fëmijët, si ndaj atyre që jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë, edhe ndaj fëmijëve që mbledhin metale të vjetra për skrap; shfrytëzimi seksual nuk është një fenomen i dukshëm, dhe kërkon hetim të mëtejshëm. Dhuna sidomos për fëmijët dhe gratë: raportohet se dhuna ndodh si në shtëpi edhe në shkollë.

Trafikimi i fëmijëve mbetet një problem shqetësues. Fëmijët trafikohen për një larmi qëllimesh, përfshirë ato për shfrytëzimin seksual, lypje të detyruar, si dhe forma të tjera të punës së detyruar, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Lypja e detyruar në rrugë e fëmijëve (kryesisht romë) në Tiranë mbetet një problem i madh, siç është edhe lypja dhe puna e detyruar (sezonale) në qendrat turistike në Shqipëri. Trafikimi ndërkombëtar i fëmijëve për në vendet fqinje, sidomos drejt Kosovës, ka qenë në rritje. Numri i fëmijëve (kryesisht romë) që punojnë dhe lypin në rrugë mbetet shumë i lartë. Ka patur raporte edhe për raste trafikimi për punë të detyruar apo shfrytëzim seksual pas martesave të ndërmjetësuara<sup>1</sup>.

Referuar studimit të kryer gjatë periudhës maj 2013-shkurt 2014 në kuadër të reformës së Shërbimeve Sociale, nga Ministria e Mirëqenies sociale dhe Rinisë, Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri, dhe ARSIS, mbështetur nga UNICEF dhe Save the Children për identifikimin e fëmijëve në situatë rrug e, rezulton se 1/3 e fëmijëve në situatë rrugë janë në

---

<sup>1</sup> Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe plani I veprimit 2014-2017

rrezik trafikimi dhe MKR-së i janë referuar mbi 31 raste të trafikimit të fëmijëve, përfshirë shfrytëzimin seksual dhe lypjen në Shqipëri dhe Kosovë<sup>2</sup>.

Fëmijët e përkatësisë rome apo egjiptiane mbartin një rrezik shumë më të lartë trafikimi dhe shfrytëzimi; përkatësia në një grup pakice etnike është e shoqëruar me varfëri, mundësi të kufizuar për përfitim nga shërbimet e mbështetja shëndetësore dhe sociale, nivel të ulët arsimor dhe papunësi të lartë. Ndër faktorët e tjerë janë varfëria dhe dhuna në familje.

Për sa i përket trafikimit të brendshëm të fëmijëve dhe adresimit të problematikave të tjera që shoqërojnë fëmijët në situatë rruge, së bashku me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Koordinatori Kombëtar Antitrafik ka hartuar një plan veprimi që përmban veprime të qarta dhe konkrete si dhe afate për realizimin e tyre. Ky plan u formalizua me firmosjen në 17 shtator 2014 të një Marrëveshjeve Mirëkuptimi mes aktorëve. Për trajtimin e duhur të këtij fenomeni, në datë 14 korrik u organizua Workshop-i me temë “Lufta kundër trafikimit të brendshëm të fëmijëve: sfidat dhe zgjidhjet”. Ky aktivitet, i cili mblodhi për herë të parë bashkë prokurorë, punonjës të shërbimit social shtetëror rajonal, inspektorë të inspektoratit shtetëror të punës dhe punonjës të policisë antitrafik, u zhvillua në Qendrën e Formimit Policor Tiranë<sup>3</sup>.

Qëllimi i studimit është identifikimi i perceptimeve, njohurive dhe qëndrimeve të të rinjve dhe mësuesve mbi të drejtat e fëmijëve dhe trafikimin njerëzor në zonat rurale të Tiranës dhe Shkodrës i zhvilluar në kuadër të projektit “*Fuqizimi i të Rinjve për të Vepruar mbi të Drejtat e tyre në zonat rurale të Tiranës dhe Shkodrës*” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe që po zbatohet nga Save the Children në partneritet me Terre des Hommes në Shqipëri.

Rezultatet e nxjerra nga analiza e pyetësorëve do të shërbejnë për të përcaktuar çështjet që do të adresohen gjatë ofrimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese me grupet e ndryshme të përfituesve të projektit.

Studimi u shtri në shkollat 9-vjecare të fshatrave të Tiranës (Fushas, Berzhite, dhe Bexulle) dhe Shkodrës (Ana e Malit, Velipoje, Rrethinat, Guri i ZI dhe Postribe). Në studim u përfshin nxënësit e klasave të 7, 8 dhe të 9-ta. Numri i nxënësve të përfshirë në studim ishte 332 nxënës. Gjithashtu në studim u përfshin edhe mësuesit që jepen mësim në këto shkolla. Numri i mësuesve që u përfshin në studim ishte 55 mësues. Duke qenë se studimi shtrihej vetëm në disa prej fshatrave të Tiranës dhe Shkodrës u përfshin në studim të gjithë nxënësit dhe mësuesit që ishin prezent ditën e intervistimit, dhe të gjitha ata që kishin dëshirë që të merrnin pjesë në studim.

Për të realizuar këtë studim është përdorur metoda sasiore e kërkimit me instrument kërkimor pyetësorin. Janë shpërndarë në total 387 pyetësorë. Pyetësori na ofron mundësinë për të mbledhur lloje të ndryshme të dhënash, mbi njohuritë, perceptimet dhe qëndrimet që kanë fëmijët dhe mësuesit në lidhje me dhunën dhe trafikimin e qënieve njerëzore.

---

<sup>2</sup> Studim “Për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge” (2014)

<sup>3</sup>

[http://ëëë.punetebrendshme.gov.al/files/programs\\_files/Materaili\\_i\\_MPB,\\_në\\_kuadër\\_të\\_takimit\\_të\\_Komitetit\\_të\\_S\\_tabilizim\\_Asociimit,\\_Mars\\_2015](http://ëëë.punetebrendshme.gov.al/files/programs_files/Materaili_i_MPB,_në_kuadër_të_takimit_të_Komitetit_të_S_tabilizim_Asociimit,_Mars_2015)

## **Kuadri ligjor**

Shqipëria ka ratifikuar konventat dhe protokollet kryesore të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës, të cilat theksojnë, se fëmijët gëzojnë të drejta të plota dhe për shkak të veçorive, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore.

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (KKBDF) është ligji më universal për të drejtat e fëmijës. Dispozitat e Konventës kërkojnë që të krijohen kushtet ekonomike, sociale, ligjore dhe institucionale për t'u garantuar fëmijëve që t'i gëzojnë dhe t'i ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre<sup>4</sup>. Me ratifikimin e Konventës në vitin 1992, Shqipëria u angazhua që të mbrojë të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, dhe të kujdeset që dispozitat dhe parimet e KKBDF-së të pasqyrohen plotësisht në legjislacionin vendas dhe efekti i tyre ligjor të garantohet në nivel vendi.

Kushtetuta e Shqipërisë siguron për mbrojtjen e të drejtave pavarësisht nga mosha dhe specifikisht për nevoja të vecanta të fëmijëve.

Në ligjin Nr. 10347 datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” përcaktohen cilat janë mekanizmat institucionalë në nivel qendror dhe vendor dhe mënyrën e bashkëveprimit të tyre për të siguruar realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

**Njësitë e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijës** janë struktura të nivelit vendor, të cilat përgjigjen për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimin e rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme, që veprojnë në nivel vendor.

*Udhëzimi katërministor Nr. 10 datë 25.02.2015 ‘Mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve’, përcakton rolin e çdo aktori në procesin e mbrojtjes së fëmijës si dhe udhëzimet e nevojshme në identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe kornizën ligjore që i mbron ata.*

Për t'u përmendur janë ndryshimet e miratuara në Kodin Penal me ligjin Nr. 144/2013, dt. 20.5.2013, të cilat ofrojnë garanci për mbrojtjen adekuate të fëmijëve nga krimet seksuale dhe shfrytëzimi ekonomik. Këto ndryshime e sjellin legjislacionin penal shqiptar në linjë me legjislacionin ndërkombëtar, në veçanti me Konventën e Këshillit të Evropës (Lanzarote) “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”<sup>5</sup>.

**Ligji i ri Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”** përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës

<sup>4</sup> Morlachetti (2013). “Sistemet gjithëpërfshirëse kombëtare për mbrojtjen e fëmijës: baza ligjore dhe praktika aktuale në Amerikën Latine dhe Karaibe”. ECLAC-UNICEF.

<sup>5</sup> Ligji Nr. 10071, datë 9.2.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës (Lanzarote) “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”

Me ndryshimet e Kodit Penal është rritur masa e dënimit për dhunën seksuale ndaj fëmijëve, (nga 15 vjet në 25 vjet burg). Nenet 107 dhe 108 të Kodit janë shtuar dhe ndryshuar për të ofruar një mbrojtje nga krimet seksuale ndaj fëmijëve. Një rregullim të plotë ligjor ka pësuar edhe Neni 117 “Pornografia”, i cili në ndryshimet e tij të fundit, e konsideron si krim edhe posedimin, rekrutimin e fëmijës dhe një serë formash të tjera të pornografisë së fëmijëve.

Neni 124, paragrafi C i Kodit, është përmirësuar, duke përfshirë të gjithë format e shfrytëzimit të fëmijëve, edhe mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik.

Me miratimin e ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit”, ofrohen disa garanci shtesë për mbrojtjen dhe mbështetjen e plotë ndaj viktimave të trafikimit, sidomos atyre fëmijë. Në nenin 17/g parashikohet identifikimi, mbrojtja dhe referimi për asistencë në autoritetet përkatëse të viktimave të trafikimit.


Me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 179, datë 19.06.2014, “Për ngritjen e Komitetit Shtetëror kundër Trafikimit të Personave”, Komiteti Shtetëror Antitrafik është zgjeruar me anëtarë të rinj. Ky mekanizëm, i cili është mjeti më i rëndësishëm në nivelin politik, është përgjegjës për përcaktimin e prioritetëve strategjike që formësojnë veprimin e antitrafikimit në Shqipëri.

Për një identifikim dhe referim më proaktiv të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit me Udhëzimin e Përbashkët Nr. 3799, datë 08.07.2014, të Ministrit të Punëve të Brendshme, Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Ministrit të Shëndetësisë, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafikim, u riorganizua dhe u zgjerua Autoriteti Përgjegjës duke përshtatur rolin dhe detyrat e tij me Procedurat Standarde të Veprimit. Rishikimi i Autoritetit Përgjegjës (AP), synoi të mbështesë implementimin efikas të marrëveshjeve të nënshkuara për mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve viktimave të trafikimit, funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, dhe monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të mundshme dypalëshe dhe/ose shumëpalëshe të ardhshme, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera në rajon dhe më gjerë për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore.

Amendimi i fundit i **Ligjit për Avokatin e Popullit**<sup>11</sup>(Ligji Nr.155/2014, datë 27.11.2014) siguron bazën ligjore për krijimin e një njësie të veçantë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në strukturën e Avokatit të Popullit, për të garantuar implementimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe për të promovuar të drejtat e tyre në parlament, qeveri dhe shoqëri civile, si dhe për të vepruar si një mediator në marrëdhëniet ndërinstitucionale, për të ndikuar në politika dhe për të organizuar forume ku të dëgjohej zëri i fëmijëve.


### **Analiza e të dhënave të nxënësve**

Të dhënat demografike të studimit në lidhje me nxënësit që morën pjesë në studim tregojnë një pjesëmarrje të 192 meshkujve dhe 148 femrave në studim.




## Të drejtat e fëmijëve sipas këndvështrimit të vet fëmijëve

Pjesa më e madhe e nxënësve (252 nxënës) raportojnë që kanë informacion për të Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, por ka dhe një pjesë nxënësish që raportojnë që nuk kanë informacion (47 nxënës) ose nuk janë të sigurt (33 nxënës).




Edhe pse nxënësit raportojnë që kanë informacion, në momentin që pyeten nëse kanë nevojë për informacion shtesë për të drejtat e fëmijëve, 200 nxënës shprehen po dhe 98 nxënës shprehen ndoshta. Nevoja për më shumë informacion pranohet nga rreth 90% e nxënësve të intervistuar.

Kur nxënësit pyeten mbi mënyrat sesi ata duan që ta marrin informacionin për të drejtat e fëmijëve, alternativa e parë më e preferuara që listohet nga nxënësit është nëpërmjet seminareve, më pas bashkëmoshatarët dhe interneti. Pjesa e ndërveprimit me specialistë dhe organizimi i orëve specifike për këtë temë shikohet me interes nga nxënësit



Në lidhje me shkëlqen e të drejtave të fëmijëve, 78 nxënës e pranojnë që shkelen të drejtat dhe 108 shprehen ndoshta. Kur pyeten se cilat janë të drejtat që ju shkelen më shumë pjesa më e madhe raportojnë që janë të drejtat e fjalës, e lirisë së shprehjes së mendimit, disa nga citimet e nxënësve janë “kur marrim pjesë në aktivitete nuk na dëgjohet mendimi”, “nuk merren për bazë


*fjalët tona*”, “*jemi të vegjël dhe gjithmonë ka të drejtë i madhi*”. Ka dhe një grup nxënësisht që japin shembuj të shkeljes së të drejtave të fëmijëve kur prindërit zgjedhin që ti cojnë fëmijët në punë. Nxënësit raportojnë situata të shkeljes së të drejtave që lidhen edhe me situata në familje por edhe me situata në shkollë.




Kur nxënësit pyetesn se kush janë personat që shkelin më shumë të drejtat, 42% e tyre shprehen për bashkëmoshatarët, 17% raportojnë se janë mësuesit, 11% prindërit, dhe 30% janë persona të tjerë që shkelin të drejtat e fëmijëve por që nuk specifikohen nga nxënësit. Shkelja e të drejtave të fëmijëve nga bashkëmoshatarët lidhet me situatat e bullizimit që ndeshen në shkolla.

### Njohuritë e nxënësve mbi të drejtat e fëmijëve


138 nxënës nuk e raportojnë neglizhimin si një shkelje të të drejtave të fëmijëve dhe 71 nxënës të tjerë nuk janë të sigurt. Të dhenat e mbeldhura nga studimi tregojnë për një mungesë informacionit mbi të drejtat dhe nevoja për fuqizimin e fëmijëve që të thonë mendimin e tyre dhe të dëgohen nga të rriturit në shkollë dhe familje.



Të dhënat tregojnë që nxënësit kanë një mungesë njohje të kuadrit ligjor që lidhet me të drejtat e fëmijëve. 62 nxënës raportojnë që në kushtetutë nuk parashikohen dhe mbrohen të drejtat e fëmijëve dhe 73 nxënës nuk janë të sigurt. Nga ana tjetër 133 nxënës raportojnë që nuk janë të sigurt nëse profesionistët duhet të raportojnë abuzimin dhe neglizhimin e fëmijës. Ka një mungesë informacioni se cilët janë profesionistët të cilët punojnë për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, dhe kjo ndoshta kufizon fëmijët që të kërkojnë ndihmë apo të referojnë fëmijë të tjetër tek këto profesionistë në momentet kur ata mund të kenë nevojë.




Një pjesë e nxënësve e pranojnë që të rriturit i rrahin fëmijët dhe 82 nxënës nuk janë të sigurt. Fakti që fëmijët nuk janë të sigurt lidhet me vështirësinë që kanë fëmijët akoma për ta pranuar dhunën dhe për ta raportuar.






97 nxënës nuk janë të sigurt nëse të rriturit respektojnë të drejtën e fëmijës për privatësi dhe 31 nxënës nuk janë dakord. Qëndrimet dhe besimet kulturore nuk janë pro privatësisë tek fëmijët pasi lidhet me kontrollin që prindërit duhet të kenë në jetën e fëmijës me të drejtën e marrjes

edhe të vendimeve në emër të fëmijëve, gjë që bie ndesh me të drejtën dhe lirin e shprehjes.




Edhe për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, 67 nxënës nuk janë të sigurt, 26 nuk janë dakord dhe 22 nuk janë aspak dakord se trajtohen në mënyrë të barabartë. Situatat që ata sjellin kanë të bëjnë si me mos trajtimin e barabartë në shkollë por edhe në familje.




## Informacionet dhe qëndrimet e nxënësve mbi shfrytëzimin seksual dhe trafikimin

Nga analiza e informacioneve vihet re se nxënësit kanë mungesë informacioni mbi çështje që kanë të bëjnë me shfrytëzimin seksual dhe trafikimin e fëmijëve. Ata i njohin pjesërisht si terma por kur kalohet në pohimet e tjera ka besime dhe qëndrime të pavërteta dhe kjo lidhte me mungesën e informacionit apo me qëndrimet dhe praktikatat kulturore që ata kanë mësuar në komunitet e tyre.


Pjesa më e madhe e nxënësve (41 nxënës shumë dakord, 93 dakord dhe 105 jo të sigurt) besojnë që fëmijët e zonave rurale nuk rrezikohen që të trafikohen shfrytëzohen për qëllime prostitucioni. Kjo tregon një mungesë të madhe të informacionit dhe të ndërgjegjësimit që të gjithë fëmijët janë njësoj të rrezikuar. Fëmijët kanë nevojë të ndërgjegjësohen për rreziqet që lidhen me largimin nga shtëpia dhe emigrimin për të fituar jetesën si diku tjetër brenda vendit apo edhe jashtë shtetit.




Një tjetër qëndrim i nxënësve mëposhte tregon që 111 nxënës nuk janë të sigurt, 12 nuk janë dakord dhe 46 nxënës nuk janë aspak dakord që pornografia e fëmijëve është një formë shfrytëzimi seksual të fëmijëve.



Mungesa e informacionit dhe qëndrimet e gabuara të nxënësve në zonat rurale përforcohen edhe më shumë në pyetjen mëposhtë. Pjesa më e madhe e nxënësve të pyetur (59 nxënës shumë dakord, 101 dakord dhe 125 jo të sigurt) mendojnë që bandat kanë më shumë gjasa që të identifikojnë fëmijët që shfrytëzohen për qëllime prostitucioni në qytete sesa në zonat rurale. Fëmijët që jetojnë në zonat ruarale besojnë që janë më të mbrojtur nga rreziqe të tilla krahasuar me fëmijët që jetojnë në zonat urbane.




Një tjetër besim i nxënësve është edhe ai që vajzat janë më shumë të rrezikuara nga trafikimi sesa djemtë (171 nxënës janë shumë dakord dhe 66 nxënës janë dakord që vajzat janë më të prekshme nga trafikimi). Ky është një besim që e kanë si djemtë dhe vajzat e intervistuar pasi lidhet me përforcimet dhe qëndrimet që ka familja, shkolla dhe shoqëria ku ata jetojnë.




### Analiza e të dhënave të mësuesve

Mësues të intervistuar ishin gjithësesj 55, prej të cilëve 24 meshkuj dhe 36 femra. Të gjithë mësuesit ishin mësues që jepnin mësim në shkollat 9-vjecvare që u përfshin në studim.




### Informacion mbi të drejtat e fëmijëve


Gjysma e mësuesve të intervistuar (28 mësues nga 55 mësues të intervistuar) raportojnë që kanë disa informacion në lidhje me të drejtat e fëmijëve. Kjo tregon nevojën për më shumë informacion mbi të drejtat e fëmijëve (32 mësues pohojnë që kanë nevojë për më shumë informacion).




21 mësues mendojnë se shkelen të drejtat e fëmijëve dhe 23 të tjerë shprehen ndoshta. Disa nga arsyet që ata listojnë sepse shkelen të drejtat e fëmijëve janë: arsye ekonomike, politike sociale; mungesa e informacionit për të drejtat e fëmijëve, mentaliteti; mos përgjegjësi e prindit për familjen e tij; mos funksionimi i ligjit.




Sipas mësuesve personat që shkelin më shumë të drejtat e fëmijëve janë prindërit dhe pastaj vijnë shokët / shoqet. Kjo bie ndesh me të dhënat që kanë dal nga analiza e pyetësorëve të nxënësve të cilët raportojnë që mësuesit ju shkelin të drejtat më shumë sesa prindërit.




Në lidhje me frekuentimin e shkollës 14 mësues pohojnë që njohin fëmijë që nuk frekuentojnë shkollën dhe 17 mësues nuk janë të sigurt. Disa nga arsyet që mësuesit listojnë sepse fëmijët nuk frekuentojnë shkollën janë: prindër të paarsimuar me gjendje të keqe ekonomike, mentaliteti i prindërve dhe i komuniteteve në të cilat jetojnë, largësia e shkollës dhe pamundësia për të paguar transportin.




Nga analiza e të dhënave të mësuesve vihet re që ka një mungesë informacioni mbi kuadrin ligjor dhe mekanizmat që veprojnë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Këto janë çështje me shumë interes për mësuesit duke qenë se gjatë praktikës së punës së tyre gjithmonë është e nevojshme të referojnë dhe të mbështesin rastet e ndryshme të fëmijëve që mund të kenë nevojë për një mbështetje të specializuar. Mësuesit nga ana tjetër duhet të kuptojnë që nuk janë specialistët e vetëm që trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.



20 mësues nuk janë të sigurt sesa të rriturit respektojnë të drejtën e fëmijës për privatësi dhe 18 mësues janë jo të sigurt që fëmijët janë të gjithë pjesëmarrës dhe shprehin lirshëm mendimet në shkollë. Kjo lidhet me besimin që fëmijët janë të vegjël dhe të rriturit e dinë më mirë se për çfarë ata kanë nevojë.




Pjesëmarrja është një nga të drejtat që është e vështirë që të vendoset në praktikë nga të rriturit. 18 mësues nuk janë të sigurt nëse fëmijët janë të gjithë pjesëmarrës në shkollë dhe e shprehin lirshëm mendimin e tyre. Në përgjithësi disa nga mësuesit mendojnë që fëmijët duhet të udhëhiqen nga të rriturit pasi ata e dinë më mirë se çfarë ju nevojitet fëmijëve. Kjo bie ndesh me parimet dhe me konceptin e vërtet të pjesëmarrjes së fëmijëve. Pjesëmarrja është një element që ka qenë në fokus dhe në vëmendjen e organizatave të ndryshme që punojnë me fëmijët të cilat kanë punuar për fuqizimin e fëmijëve për një pjesëmarrje në jetën shkollore.




### Trafikimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve

Edhe mësuesit (16 mësues janë dakord, 21 mësues nuk janë të sigurt) mendojnë që fëmijët në zonat rurale nuk rrezikohen të trafikohen, shfrytëzohen për qëllime prostitucioni. Kjo lidhet me mungesën e informacionit dhe me nevojën për më shumë informacion në lidhje me trafikimin, shkaqet, pasojat, grupet e rrezikuara, etj.



Edhe për mësuesit besimi është se vajzat janë më të prekshme nga trafikimi sesa djemtë. Ka diferenca edhe në shumë nga pohimet e tjera që kërkojnë informacion mbi trafikimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve, cka tregon nevojën për më shumë informacion në këto fusha dhe një ndërgjegjësim të fëmijëve, mësuesve dhe prindërve.





## Gjetjet e nxënësve

- 75% e nxënësve raportojnë se kanë informacion për të konventën e të drejtave të fëmijëve por nga ana tjetër 60% e nxënësve shprehen se kanë nevojë për informacion shtesë në lidhje me të drejtat e fëmijëve. Informacionet që ata kanë janë shumë bazike, ndërkohë që ka nevojë për një qasje më të thelluar të të drejtave të fëmijëve.
- Seminaret shikohen si një nga alternativat më interesante për nxënësit për marrjen e informacionit për të drejtat e fëmijëve
- 24% e nxënësve raportojnë që shkelen të drejtat dhe 33% thonë ndoshta. Të drejtat që shkelen më shumë janë të drejtat e fjalës, e lirisë së shprehjes së mendimit. Këto të drejta shprehen nga shkolla si dhe nga prindërit. 42% e tyre shprehen për bashkëmoshatarët, 17% raportojnë se janë mësuesit, 11% prindërit, dhe 30% janë persona të tjerë që shkelin të drejtat e fëmijëve por që nuk specifikohen nga nxënësit.
- 42% e nxënësve nuk e pranojnë që neglizhimi është një shkelje e të drejtave të fëmijëve dhe 21% e nxënësve nuk janë të sigurt. Fëmijët kanë një mungesë informacioni mbi neglizhimin si një nga format e abuzimit.
- Nxënësit kanë një mungesë njohje të kuadrit ligjor që lidhet me të drejtat e fëmijëve.
- 29% e nxënësve nuk janë të sigurt nëse të rriturit respektojnë të drejtën e fëmijës për privatësi
- Nxënësit kanë mungesë informacioni mbi çështje që kanë të bëjnë me shfrytëzimin seksual dhe trafikimin e fëmijëve. Ata i njohin pjesërisht si terma por kur kalohet në pohimet e tjera ka besime dhe qëndrime të pavërteta dhe kjo lidhet me mungesën e informacionit apo me qëndrimet dhe praktikat kulturore që ata kanë mësuar në komunitet e tyre.

- Pjesa më e madhe e nxënësve (12% nxënës shumë dakord, 28% dakord dhe 32% jo të sigurt) besojnë që fëmijët e zonave rurale nuk rrezikohen që të trafikohen, shfrytëzohen për qëllime prostitucioni.
- Besim i nxënësve është edhe ai që vajzat janë më shumë të rrezikuara nga trafikimi sesa djemtë (52% e nxënësve janë shumë dakord dhe 20% e nxënësve janë dakord që vajzat janë më të prekshme nga trafikimi)

### **Gjetjet e mësuesve**

- Gjysma e mësuesve të intervistuar raportojnë që kanë disi informacion në lidhje me të drejtat e fëmijëve.
- 38% e mësuesve mendojnë se shkelen të drejtat e fëmijëve dhe 42% të tjerë shprehen ndoshta. Disa nga arsyet që ata listojnë sepse shkelen të drejtat e fëmijëve janë: arsye ekonomike, politike sociale; mungesa e informacionit për të drejtat e fëmijëve, mentaliteti; mos përgjegjësi e prindit për familjen e tij; mos funksionimi i ligjit.
- Sipas mësuesve personat që shkelin më shumë të drejtat e fëmijëve janë prindërit dhe pastaj vijnë shokët / shoqet. Nxënësit nga ana tjetër raportojnë që mësuesit ju shkelin të drejtat më shumë sesa prindërit.
- 25% e mësuesve pohojnë që njohin fëmijë që nuk frekuentojnë shkollën dhe 31% e mësuesve nuk janë të sigurt. Disa nga arsyet që mësuesit listojnë sepse fëmijët nuk frekuentojnë shkollën janë: prindër të paarsimuar me gjendje të keqe ekonomike, mentaliteti i prindërve dhe i komuniteteve në të cilat jetojnë, largësia e shkollës dhe pamundësia për të paguar transportin.
- Nga analiza e të dhënave të mësuesve vihet re që ka një mungesë informacioni mbi kuadrin ligjor dhe mekanizmat që veprojnë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- 36% e mësuesve nuk janë të sigurt sesa të rriturit respektojnë të drejtën e fëmijës për privatësi dhe 33% e mësuesve janë jo të sigurt që fëmijët janë të gjithë pjesëmarrës dhe shprehin lirshëm mendimet në shkollë.
- Edhe mësuesit (29% e mësuesve janë dakord, 38% e mësuesve nuk janë të sigurt) mendojnë që fëmijët në zonat rurale nuk rrezikohen të trafikohen, shfrytëzohen për qëllime prostitucioni. Kjo lidhet me mungesën e informacionit dhe me nevojën për më shumë informacion në lidhje me trafikimin, shkaqet, pasojat, grupet e rrezikuara, etj.
- Edhe për mësuesit besimi është se vajzat janë më të prekshme nga trafikimi sesa djemtë. Ka diferenca edhe në shumë nga pohimet e tjera që kërkojnë informacion mbi trafikimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve, cka tregon nevojën për më shumë informacion në këto fusha.

## **Rekomandimet**

- Organizmi i sesioneve informuese me fëmijët për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, pjesëmarrjen, kuadrin ligjor për të drejtat e fëmijëve, trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve.
- Përfshirja e fëmijëve në ideimin e aktiviteteve në shkollë që kanë në fokus të drejtat e fëmijëve dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre.
- Ndërgjegjësimi dhe informimi i mësuesve mbi çështje që kanë të bëjnë me trafikimin, të drejtat e fëmijëve (në vecanti pjesëmarrja) dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen edhe të drejtat e fëmijëve.
- Bashkëpunimi i mësuesve dhe nxënësve për organizmin e aktiviteteve të përbashkëta që kanë në fokus të drejtat e fëmijëve.